

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5456
E premte, 20 prill 2018
çmimi 0.40 €

Limaj nis jetësimin e projektit për çdo familje nga një të punësuar

FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

FRIKA NGA 'AMBIENTI I MBYTUR ME IDEALIZËM'! F. 11

Jakup KRASNIQI



KOSOVA ARRIN PROGRES NË FUSHËN E KONTROLLIT TË ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA F. 7

HAPET KONKURS PËR 62 POZITA NË UP F. 6

EKONOMI

CETEP-I SYNON SHFRYTËZIMIN E POTENCIALIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME F. 8

PARTITË POLITIKE NUK TREGOJNË SE NGA I MARRIN PARATË F. 8

KULTURË

REXHEP ISMAJLI, ANËTAR I AKADEMISË SË ARTEVE DHE TË SHKENCAVE TË AMERIKËS F. 12

SPORT

'FUSHË-KOSOVA' SYNON TË LË GJURMË NË GJIMNASTIKË F. 13

KËTË FUNDJAVË PËRFUNDON SEZONI I RREGULLT NË BASKETBOLL F. 13



FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOXHAI F. 4-5

Platforma shtetërore synon arritjen e unitetit politik për dialogun me Serbinë

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka bërë me dije se platforma shtetërore për finalizimin e dialogut të Kosovës me Serbinë, e miratuar të enjten nga Qeveria, synon arritjen e marrëveshjes ligjërish të obligueshme për të dyja palët, që nënkupton njohjen e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se kjo marrëveshje mundëson edhe anëtarësimin e Kosovës në OKB, në BE dhe në NATO.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka treguar se kjo platformë parashihet edhe krijimin e një mekanizmi të krijuar nga Kuvendi për ta përfaqësuar Kosovën në dialog, por që procesi i dialogut do të udhëhiqet nga presidenti Hashim Thaçi. Ai ka thënë se kjo platformë synim kryesor ka arritjen e një uniteti politik në mes të partive në pushtet dhe atyre në opozitë për procesin e dialogut me Serbinë

Tahiri: OKB-ja po vetëdijesohet për gratë e dhunuara në Kosovë

Drejtesja e bordit për organizimin e peticionit "Kërkojmë drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë", Edita Tahiri, ka deklaruar se OKB-ja ka filluar të vetëdijesohet për gratë e dhunuara në

Kosovë. Ajo ka treguar për gazetën "Epoka e re" se kjo është parë në mbledhjen e fundit të Këshillit të Sigurimit, ku këtë çështje e kanë adresuar disa shtete të fuqishme. Ish-zëvendëskryeministrja Tahiri ka bërë



me dije se do të vazhdohet adresimi i kësaj çështje derisa OKB-ja të hartojë një raport për gratë e dhunuara gjatë luftës në Kosovë F. 3



Hoxha para deputetëve: Liberalizimi, këtë vit

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka raportuar të enjten në Komisionin për Integritim Evropian në lidhje me Raportin e

Progresit. Ajo është shprehur e bindur se lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës do të realizohet deri në fund të vitit F. 3

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjobiznesi.com
info@kolegjobiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj, Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pacolli: Mbështetja e ShBA-së për Kosovën, e pazëvendësueshme

PRISHTINË, 19 PRILL - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka pritur të enjten në një takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë (ShBA), Greg Delawie,

me të cilin ka biseduar për zhvillimet e fundit politike në vend si dhe për koordinimin e hapave dhe veprimeve në marrëdhëniet me jashtë. "Zhvillova një takim të rregullt pune me ambasadorin amerikan në Kosovë, Greg Delawie.

Shkëmbyem pikëpamjet mbi zhvillimet më të fundit politike në vend dhe bashkëbiseduam në mënyrën më miqësore mbi koordinimin dhe bashkërendimin e hapave dhe veprimeve të vendit tonë në marrëdhëniet me jashtë.

Mbështetja e ShBA-së, si aleat strategjik i vendit tonë, mbetet e pazëvendësueshme si në aspektin e zhvillimeve të brendshme politike, po ashtu edhe atë të forcimit të legjitimitetit ndërkombëtar dhe anëtarësimit të Kosovës në



organizatat ndërkombëtare", ka thënë Pacolli.

Palmeri: Rusia, kërcënimi më i madh i jashtëm ndaj vendeve të Ballkanit

Drejtori i Departamentit të Shtetit për Evropën Jugore dhe Qendrore, Matthew Palmer, në seancën dëgjimore në Kongresin Amerikan, tha se Rusia është kërcënimi më i madh i jashtëm ndaj vendeve të Ballkanit

WASHINGTON, 19 PRILL - Shtetet e Bashkuara duhet ta vazhdojnë angazhimin për t'i ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor, u shprehën pjesëmarrësit në një seancë dëgjimore të mbajtur në Nënkomisionin për Evropën të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan.

Pjesëmarrësit theksuan se njëzetet vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit, qëndrueshmëria e rajonit po kërcënohet nga ndikimi i dëmshëm nga faktorë të jashtëm, mungesa e përparimit në procesin e integritit euroatlantik dhe konfliktet e pazgjidhura.

Matthew Palmer, drejtor i Departamentit të Shtetit për Evropën Jugore dhe Qendrore, i ftuar për të dëshmuar në seancë, tha se Rusia është kërcënimi më i madh i jashtëm ndaj vendeve të Ballkanit. "Aktori i jashtëm, për të cilin jemi të shqetësuar në këtë kohë, është Federata Ruse.

Qëllimet e tyre, jo vetëm në Bosnjë, por në të gjithë rajonin, në thelb janë në kundërshtim me qëllimet tona. Ne po punojmë për t'i integruar vendet e Ballkanit Perëndimor në institucionet euroatlantike, ndërsa në të njëjtën kohë rusët po punojnë për të mbjellë mosbesim dhe konflikt. Kjo është shqetësuese për ne. Ne jemi të shqetësuar në lidhje me fushatën ruse të dezinformimit dhe mbështetjen ruse për grupet në Bosnjë që po punojnë për shkatërrimin e identitetit të vendit", tha Palmeri.

Pavarësisht se rajoni nuk është aktualisht i kërcënuar nga një konflikt i dhunshëm, mosangazhimi i Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian për t'iu kundërvënë ndikimit të jashtëm dhe për t'i trajtuar problemet e tjera mund të krijojë kushtet për konflikt në të ardhmen, thanë pjesëmarrësit. Amerika ka një përgjegjësi të



vazhdueshme për t'i ndihmuar vendet e rajonit për t'i zgjidhur problemet e mbetura, tha ligjvënësi republikan Dana Rohrabacher, kryetar i Nënkomisionit për Evropën. "Nuk mund të rrimë mënjatë dhe të presim që Bashkimi Evropian t'i zgjidhë problemet. Përvoja ka treguar se Evropës i mungon vendosmëria politike për të udhëhequr dhe angazhimi ynë aktiv tani, do t'i pakësonte shanset për ndërhyrje më sfiduese në të ardhmen", tha ligjvënësi Dana Rohrabacher.

Ndërsa ligjvënësi demokrat Gregory Meeks theksoi se mbështetja e Komisionit Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësim për Shqipërinë dhe Maqedoninë është një zhvillim inkurajues. Por, sipas tij, rajoni përballë me një ngadalësim të përparimit në procesin e integritimeve euroatlantike dhe me një rritje të ndikimit negativ nga jashtë. "Banorët e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk janë më aq të bindur mbi përfitimet nga anëtarësimi në BE dhe NATO, si dikur, dhe aktorët e

jashtëm si Turqia dhe Rusia janë gjithnjë e më të interesuar dhe më të gatshëm për të ndërhyrë në mënyrë të dëmshme, duke rrezikuar investimet që ShBA-ja ka bërë drejt paqes demokratike në rajon", tha ai.

Shirley Cloye DioGuardi nga Lidhja Shqiptaro-Amerikane theksoi para ligjvënësve nevojën për zgjidhjen e konflikteve të mbetura etnike, sidomos atij në Maqedoni. Ajo tha se ShBA-ja duhet të vë theksin te respektimi i të drejtave të komuniteteve. "Politika e jashtme amerikane në Ballkan në 20 vjetet e fundit është përqendruar në arritjen e stabilitetit me çdo kusht, në vend se ta vendosim parandalimin e konfliktit dhe respektimin e të drejtave të njeriut në qendër të angazhimit tonë me rajonin. Si rezultat, pas Marrëveshjes së Dejtonit, konflikti në Ballkan mbetet ende i pazgjidhur", tha ajo. Korrupsioni dhe institucionet e dobëta janë një sfidë tjetër e vendeve të Ballkanit Perëndimor, që thekson nevojën për një angazhim më të madh amerikan dhe evropian për ta ndihmuar rajonin për trajtimin e këtyre sfidave, thanë pjesëmarrësit.

NATO-ja kërkon zgjidhje të përhershme për Kosovën



BEOGRAD, 19 PRILL - Kryetari i Serbisë, Aleksandar Vučić, dhe kryetari i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Paolo Ali, deklaruan se ka një pajtueshmëri se mes të NATO-s dhe Serbisë dhe se ekziston një dialog intensiv në nivele më të larta. Kryetari i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Paolo Ali, deklaroi se "NATO-ja respek-

ton pozicionin e Serbisë që të jetë neutrale në fushën ushtarake dhe që bashkëpunimi të ndodhë sipas nevojës", njoftojnë mediet serbe. Ai theksoi se Serbia po kontribuon për paqen në rajon. Ndërkaq në takimin që Paolo Ali pati me kryeministren serbe, Ana Brnabić, u diskutua për angazhimin e Serbisë në kuadër të NATO-s, në programin

"Partneritetit për paqe". Kryeministrja e Serbisë, Ana Brnabić, theksoi se prania e KFOR-it në Kosovë është e një rëndësie të veçantë. Ndërsa anëtarët e delegacionit të NATO-s në krye me Paolo Ali, theksuan se e kuptojnë çështjen e Kosovës si një nga çështjet tejet të ndjeshme, ndaj është e rëndësishme të gjendet zgjidhje e përhershme.

Vlahutin takon Bashën

TIRANË, 19 PRILL - Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Romana Vlahutin, i ka dorëzuar kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha, rekomandimin pozitiv të

Komisionit Evropian për çeljen e negociatave për anëtarësim në BE. Takimi Vlahutin - Basha është zhvilluar në ambientet e Kryesisë së Kuvendit. Në seancën e plenare të së

enjtës, kryedemokrati Basha tha nga foltorja e Kuvendit, se rruga evropiane e Shqipërisë është e vetmja mundësi për të ngritur institucione të besueshme dhe demokratike.

Sipas kreut të PD-së, "Rruga evropiane është e vetmja mundësi që kemi për ta ndarë politikën nga krimi dhe për të shpëtuar Shqipërinë nga droga".



Këshilli i Sigurimit i OKB-së përmend çështjen e grave të dhunuara në Kosovë

Tahiri: OKB-ja po vetëdijesohet për gratë e dhunuara në Kosovë

Drejtesja e bordit për organizimin e peticionit "Kërkojmë drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë", Edita Tahiri, ka deklaruar se OKB-ja ka filluar të vetëdijesohet për gratë e dhunuara në Kosovë. Ajo ka treguar për gazetën "Epoka e re" se kjo është parë në mbledhjen e fundit të Këshillit të Sigurimit, ku këtë çështje e kanë adresuar disa shtete të fuqishme. Ish-zëvendëskryeministrja Tahiri ka bërë me dije se do të vazhdohet adresimi i kësaj çështje derisa OKB-ja të hartojë një raport për gratë e dhunuara gjatë luftës në Kosovë

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 PRILL - Drejtesja e bordit për organizimin e peticionit "Kërkojmë drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë", Edita Tahiri, ka bërë me dije se OKB-ja ka filluar të vetëdijesohet rreth kësaj çështje. Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ajo ka treguar se shenjat pozitive janë parë në mbledhjen e fundit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ku përfaqësuesit e disa vendeve evropiane kanë folur për këtë çështje. "Angazhimet tona për ta ndërkombëtarizuar dhe ngritur vetëdijen ndërkombëtare, sidomos të OKB-së, për tragjedinë e grave të dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë, kanë pasur zhvillime pozitive kohët e fundit. Në debatin që është zhvilluar në Këshillin e Sigurimit këtë javë, disa shtete kanë përmendur se çështja e grave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë duhet të ngrihet dhe ta marrë vëmendjen e OKB-së", ka thënë Tahiri. Ajo ka treguar se kërkesa e këtij

bordi është që sekretari i përgjithshëm i OKB-së të bëjë një raport për gratë e dhunuara gjatë luftës në Kosovë dhe Kroaci. "Shtetet që e kanë përmendur këtë çështje janë: Franca, Gjermania, Britania, Austria dhe Kroacia. Kjo vjen edhe si rezultat i angazhimeve në kuadër të peticionit që e kemi përgatitur si bord drejtues i grave të Kosovës, i cili ende nuk është pranuar nga OKB-ja, ani pse për këtë çështje dy herë i kemi shkruar sekretarit gjeneral të OKB-së. Pastaj kemi rritur kërkesën tonë përmes lobit rajonal të grave, ku kemi kërkuar që OKB-ja të bëjë raport për Kosovën dhe Kroacinë, sepse Bosnja përmendet në raport, por në mënyrë shumë sipërfaqësore", ka thënë Tahiri.

Ish-zëvendëskryeministrja ka treguar edhe për personalitetet e tjera që kanë ndihmuar në adresimin e kësaj çështje. "Falë angazhimeve të bordit drejtues të grave për peticionin e Kosovës, Lobit Rajonal të Grave të Evropës Juglindore dhe të konsullës sonë në Nju Jork, Teuta Sahatqija, që është edhe anëtare e lobit,



arritëm që për herë të parë çështja e grave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë, nga forcat serbe, të përmendet nga shtetet e rëndësishme. Puna jonë dhe imja si kryetare e Lobit Rajonal dhe bordit të grave të Kosovës do të vazhdojë derisa drejtësia ndërkombëtare të vendoset, ndërsa kryesit e këtyre krimeve ta marrin dënimin e merituar", ka thënë Tahiri.

Më tej, ajo ka vlerësuar se nuk do të ndalen së ndërkombëtarizuarit këtë çështje derisa sekretari i OKB-së të bëjë një raport për këtë çështje. "Mendoj se këto janë rezultatet e para të peti-

cionit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, i cili i dha mesazh të qartë botës se nuk mund të mbahet i fshehur ky gjenocid ndaj grave, pra i grave të dhunuara të Kosovës gjatë luftës prej forcave serbe. Në fazën vijuese ne do t'i vazhdojmë angazhimet diplomatike dhe jam e bindur se as OKB-ja në pafundësi nuk mund ta injorojë këtë çështje. Por, një ditë do të marrë vendim që të bëjë raport zyrtar për atë se çfarë ka ndodhur në Kosovë me gratë e dhunuara", ka thënë ajo.

Sipas Tahirit, Organizata e Kombeve të Bashkuara deri më tani ka bërë disa raporte për

dhunimin e grave gjatë konflikteve të ndryshme në botë, por asnjëherë nuk e ka përmendur Kosovën. "Ky është raporti i tetë me radhë që sekretari gjeneral i OKB-së përgatit për çështje të grave të dhunuara gjatë luftërave, mirëpo ende nuk i ka përfshirë as Kosovën dhe as Kroacinë. Këto shtete që kanë ngritur këtë çështje jam bindur se ky proces ka marrë një rrugë të mbarë dhe ne do t'i vazhdojmë angazhimet diplomatike dhe të gjitha format e tjera për ta arritur qëllimin tonë, që është hartimi i këtij raporti nga OKB-ja", ka thënë Tahiri.

Hoxha para deputetëve: Liberalizimi, këtë vit



PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka raportuar të enjten në Komisionin për Integritet Evropian në lidhje me Raportin e Progresit. Ajo ka theksuar se ky raport ka shumë vlerësime pozitive, duke përfshirë zgjedhjet nacionale dhe lokale të vitit të kaluar, ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi dhe ekzistimin e një mjedisi pluralist dhe dinamik të medieve. "Progres ka pasur edhe në fushën e Reformës së Administratës Publike dhe rishikimin e agjencive dhe trupave te pavarura, në sistemin e drejtësisë ka përparime në zbatimin e pakos ligjore të vitit 2015, në veçanti në integrimin e

gjyqtarëve dhe prokurorëve të komunitetit serb në sistemin e drejtësisë së Kosovës", ka thënë Hoxha. Po ashtu, ajo ka thënë se në raport vlerësohet edhe lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. "Raporti nënvizon se Kosova ka vazhduar masat për marrëdhënie të mira dhe konstruktive bilaterale me vendet e rajonit, njëkohësisht vlerësohet angazhimi ynë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", ka thënë Hoxha. Ministrja Hoxha është shprehur e bindur se lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës do të realizohet deri në fund të vitit. Më tutje, Hoxha ka thënë se në Raportin e Progresit janë evidentuar edhe disa nga sfidat që ka Kosova.

Flet për "Epokën e re", Enver Hoxhaj

Platforma shtetërore synon arritjen e u



Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka bërë me dije se platforma shtetërore për finalizimin e dialogut të Kosovës me Serbinë, e miratuar të enjten nga Qeveria, synon arritjen e marrëveshjes ligjërish të obligueshme për të dyja palët, që nënkupton njohjen e ndërsjellët në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se kjo marrëveshje mundëson edhe anëtarësimin e Kosovës në OKB, në BE dhe në NATO. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka treguar se kjo platformë parasheh edhe krijimin e një mekanizmi të krijuar nga Kuvendi për ta përfaqësuar Kosovën në dialog, por që procesi i dialogut do të udhëhiqet nga presidenti Hashim Thaçi. Ai ka thënë se kjo platformë synim kryesor ka arritjen e një uniteti politik në mes të partive në pushtet dhe atyre në opozitë për procesin e dialogut me Serbinë

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 19 PRILL -

"Epoka e re": Z. Hoxhaj, Qeveria e Kosovës të enjten ka miratuar Platformën shtetërore për finalizimin e dialogut me Serbinë. Cila është përmbajtja e saj?

Hoxhaj: E kam thënë edhe më herët se Kosovës i duhet një platformë në të cilën përfshihen pritjet nga dialogu me Serbinë. Pas një procesi të gjatë konsultues, Qeveria e Kosovës ka hartuar platformën shtetërore për finalizimin e dialogut me Serbinë. Kjo platformë është miratuar të enjten nga kabineti qeveritar, më pas është dërguar në Kuvendin e Kosovës. Platforma synon arritjen e marrëveshjes ligjërish të obligueshme për të dyja palët e cila nënkupton njohjen e

ndërsjellët në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kjo marrëveshje duhet ta mundësojë edhe anëtarësimin e Kosovës në OKB, në BE dhe në NATO. Po ashtu, platforma parasheh edhe krijimin e një mekanizmi të krijuar nga Kuvendi për ta përfaqësuar Kosovën në dialog, por procesi i dialogut do të udhëhiqet nga presidenti. Platforma është një dokument orientues dhe besoj se do ta marrë mbështetjen e të gjitha partive politike në Kuvend.

"Epoka e re": Është përcaktuar periudha kohore e përfundimit të procesit të dialogut në këtë platformë?

Hoxhaj: Ne e kemi një çështje të hapur me Serbinë dhe kjo është mungesa e njohjes së ndërsjellët dhe marrëdhënieve diplomatike, që është bërë problem për

Kosovën që të anëtarësohet në OKB, derisa për Serbinë është bërë pengesë për anëtarësim në BE. Afate kohore nuk ka, por Kosova, Serbia dhe partnerët tanë evropianë e amerikanë do të duhej të dalin me një plan kohor për fazën finale të procesit. Çdo herë kam avokuar që ta kemi një kufizim të dialogut në kohë dhe në përmbajtje. Me këtë platformë realisht Kosova hynë në fazën e fundit të dialogut për normalizim të raporteve me Serbinë. Normalizimi i raporteve mund të ndodhë vetëm atëherë kur të kemi njohje të ndërsjellët dhe anëtarësim në OKB.

"Epoka e re": Është platforma e njëjtë baza e së cilës i është dorëzuar BE-së me herët nga ish-kryenegociatorja Edita Tahiri, që njihet si dokumenti i

Unitetit politik për dialogun me Serbinë

"Epoka e re": Prisi mbështetjen e opozitës e cila nuk ka qenë pjesë e hartimit të platformës?

Hoxhaj: Fakti që platforma është hartuar dhe propozuar nga qeveria ka të bëjë me atë se çfarë është Qeveria në sistemin tonë kushtetues dhe politik. Qeveria propozon dokumente që janë të rëndësishme sa i takon politikës së jashtme në raport me Kuvendin. Pastaj i takon Kuvendit që ta marrë vendimin e fundit dhe ta vulosë këtë platformë. Pra, është Kuvendi i Kosovës vendi ku krijohet uniteti. Ideja e platformës është që të kemi unitet në mes të gjitha partive politike, atyre që janë në koalicion qeverisës dhe atyre që janë në opozitë, meqë politika e jashtme është një temë që duhet të na bashkojë dhe jo të na ndajë. Temat e interesit strategjik janë tema të të gjithë atyre të cilët janë në politikë, pavarësisht se kush mund të jetë përkohësisht në pushtet dhe në opozitë. Ideja e platformës është arritja e një konsensusi politik në mes të gjitha partive politike.

"Epoka e re": Si mendoni të arrihet këtë konsensus kur kemi parasysh ndasitë që ekzistojnë në skenën politike?

Hoxhaj: Si qeveri kemi shprehur

vullnetin tonë politik për arritjen e unitetit, kurse u takon partive politike të deklarohen dhe të marrin qëndrim për këtë. Shënimi i vijës së kufirit me Malin e Zi është shembulli më i mirë në këtë drejtim. Ndonëse demarkacioni ka qenë temë që ka krijuar ndasi, megjithatë në fund kemi arritur të krijojmë një unitet të brendshëm politik, falë të cilit patëm 80 vota që mbyllën këtë temë njëherë e përgjithmonë. Ky është një model i mirë se si të shkohet përpara. Nuk ka rëndësi kush është në pushtet e kush në opozitë për temat e politikës së jashtme, meqë ato kanë të bëjnë me interesin vital të Kosovës. Në këtë frymë shpresoj se platforma do ta ketë një mbështetje të tillë në Kuvendin e Kosovës.

"Epoka e re": Nuk mendoni se kjo platformë është dashur të hartohet nga të gjitha institucionet dhe nga opozita?

Hoxhaj: Qeveria e ka dërguar versionin e parë të platformës, tash është në dorën e Kuvendit se çfarë do të vendosë. Deputetët mund të vendosin për të hequr ndonjë pjesë apo për të shtuar ndonjë pjesë të re në platformë, madje mund të dalin edhe me

propozime të reja dhe aty mund të krijohet një qasje e përbashkët. Politikisht është në rregull edhe si procedurë. Pra, është në rregull që si Qeveri kemi propozuar një platformë e cila duhet të diskutohet dhe të miratohet në Kuvend.

"Epoka e re": Kur prisni që Kuvendi ta miratojë këtë platformë?

Hoxhaj: Kjo është çështje që i takon Kuvendit. Ne si Qeveri kemi të gatshëm të debatojmë për këtë platformë kurdo që Kuvendi e cakton seancën.

"Epoka e re": Z. Hoxhaj, një prej rekomandimeve në Raportin e Progresit ka qenë edhe vazhdimi i dialogu me Serbinë dhe arritja e marrëveshjes në mes të dy vendeve. Në përgjithësi, si e vlerësoni këtë raport?

Hoxhaj: Raporti i Progresit ka evidentuar progresin e arritur të Kosovës në disa fusha, por ka përmendur edhe ngecjet dhe sfidat. Është raport i cili e përfshinë punën e dy qeverive. Pritja kryesore që kanë pasur qytetarët e Kosovës sa i takon liberalizimit të vizave është përcjell me vënien e një drite të gjelbër. Komisioni Evropian do

të dërgojë edhe një ekip të ekspertëve që do të merret me këtë temë në mënyrë të veçantë, meqë liberalizimi i vizave nuk është temë e cila ka të bëjë me integrimin evropian të Kosovës, por është një binar i ndarë që është trajtuar pozitivisht në raport. Ndërsa për gjetjet e tjera do të dalim me një plan të veprimit dhe do t'i adresojmë të gjitha.

"Epoka e re": Pavarësisht prej progresit, Kosova ka mbetur mbrapa në krahasim me vendet e tjera në procesin e integritimit?

Hoxhaj: Kosova qëndron njëjtë sikurse vendet e rajonit qoftë për kriteret politike, kriteret ekonomike dhe kriteret sociale. Këtu nuk ka asnjë dallim, por dallimi i vetëm është që Kosova ka ndërtuar një raport kontraktual me Brukselin në tre vjetët e fundit me nënshkrimin e MSA-së, ndërsa vendet e tjera e kanë nisur në vitet 2001-2002 si dhe në vitet 2006-2007. Kështu që, vendet e tjera janë para nesh sepse kanë filluar procesin më herët. Ne kemi më të vonë në këtë proces sepse lindja e shtetit tonë ka qenë më i vonë. Kjo është arsyeja pse Kosova është më vonë në agjendën evropiane.

Qeveria harton platformën për bisedimet me Serbinë

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar të enjten platformën shtetërore për finalizimin e dialogut të Kosovës me Serbinë. Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se platforma siguron proces transparent dhe gjithëpërfshirës. Ai ka treguar se ky dokument do të procedohet në Kuvendin e Kosovës dhe, nëpërmjet tij, synohet të arrihet një qëndrim unik i institucioneve të vendit ndaj këtij procesi. "Ne vetëm e sponsorizojmë platformën, kurse

Kuvendit i mbetet të vendosë. Ashtu siç do të vendosë Kuvendi, ne do ta respektojmë. Andaj u lutem deputetëve t'i përgjigjen kohës, etapës në të cilën ndodhemi, sepse ky dialog është shterur dhe nuk po prodhon efekte dhe nuk po jep rezultate. Kështu që, duhet të kalojmë në fazën finale dhe duhet të insistojmë për këtë", ka thënë Haradinaj. Kryeministri ka deklaruar edhe një herë se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe

do të themelohet në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Sipas tij, ultimatumit i dhënë nga Lista Serbe se, nëse nuk bëhen hapa konkretë nga Qeveria e Kosovës, ata do ta themelojnë atë njëanshëm, nuk paraqet ndonjë efekt. "Ka ndryshuar gjendja faktike, Kosova është në proces e sipër të themelimit të statutit në përputhje me marrëveshjen e Brukselit. Marrëveshja e Brukselit e ka paraparë që në fund të procesit, vlerësimin

rreth harmonizimit të statutit do ta japë Gjykata Kushtetuese e Kosovës", ka deklaruar Haradinaj. Pas mbledhjes së Qeverisë, Haradinaj ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave, duke u shprehur i bindur se qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza në Zonën Shengen brenda javësh. "Besoj se liberalizimin e vizave do ta marrim në javët në vazhdim", është shprehur kryeministri Haradinaj.

temave për fazën përfundimtare të dialogut?

Hoxhaj: Nuk e di që znj. Tahiri ka dorëzuar ndonjëherë ndonjë platformë të karakterit politik. Është e vërtetë se në vitin 2011 kemi bërë një dokument strategjik i cili na ka shërbyer si Qeveri për të hyrë në proces të dialogut me Serbinë të udhëhequr nga BE-ja. Atëherë Kuvendi pati miratuar një rezolutë me të cilën ka mandatuar Qeverinë për ta drejtuar këtë proces. Tash Qeveria ka dalë me një dokument të cilin ia ka adresuar Kuvendit të Kosovës. Tashme duhet të arrijmë një unitet të plotë politik ndërmjet partive të koalicionit qeverisës dhe atyre në opozitë dhe të shohim se si do të përfaqësohemi në proces të dialogut.



Hapet konkurs për 62 pozita në UP

PRISHTINË, 19 PRILL - Në mbledhjen e Senatit të Universitetit të Prishtinës është miratuar të enjten, pas shumë diskutimeve, konkursi për 62 pozita në këtë institucion arsimor. Rektori i UP-së, Marjan Dema, ka thënë se konkursi është hapur për pozitat e profesorëve të pensionuar dhe pozita të reja. "Kësaj radhe kemi 62 pozita. Ka pozita që janë pensionuar profesorë dhe pozita të reja që e kemi parë të nevojshme", ka thënë Dema. Dema ka kërkuar diskutim për këtë konkurs me qëllim të transparencës dhe miratimit të tij pas diskutimeve. Ai ka bërë me dije se njësitë akademike kanë dërguar kërkesa për 293 pozita por, sipas tij, UP-ja lëngon për mungesë buxheti dhe staf akademik e joakademik. Dekani i Fakultetit Filozofik,

Bujar Dugolli, ka kundërshtuar reduktimin e pozitave të kërkuara nga kjo njësi akademike, por është pajtuar me konkursin, duke përdorur shprehjen "më mirë pak se hiq". Ai ka thënë se nuk duhet të ketë dallim mes stafit të rregullt dhe të angazhuar si dhe mes njësitë akademike. Dugolli ka kërkuar që në konkurs të futet edhe një pikë me të cilën përjashtohen ata që janë dënuar për vepra penale, ndërsa është ankuar se Këshilli Drejtues i UP-së nuk po takohet me dekanët. Në mbledhjen e Senatit të UP-së, Avdi Puka, senator nga Fakulteti Juridik, ka kërkuar të mos jenë pjesë e konkursit pozitat e atyre që po përballeshin me gjykatat. Këtë ide e ka mbështetur edhe rektori Dema.



Miratohet raporti vjetor i AKK-së për vitin 2017

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 19 PRILL - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka shqyrtuar të enjten raportin vjetor të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) për vitin 2017. Drejtori i AKK-së, Shaip Havolli, duke prezantuar raportin për vitin e kaluar, ka folur edhe për ndryshimet legjislative, me theks të veçantë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për këtë agjenci dhe Ligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë. Ai në vazhdim ka dhënë sqarime të shumta në çështje të ndryshme që u ngritën nga anëtarë të këtij komisioni. Havolli, duke prezantuar

ndryshimet legjislative, ka sqaruar se hetimet paraprake do të ekzistojnë në ligjin e ri dhe se ato madje do të fuqizohen. Po ashtu, ai ka thënë se do të shtohet dhe vlerësimi i rrezikut nëpër sektorë dhe se agjencia do të ketë të drejtë ta bëjë vlerësimin e vet nëpër sektorë ngaqë AKK-ja, sipas tij, tashmë ka të gjitha mekanizmat ligjorë. Sipas tij, Strategjinë Kundër Korrupsionit tanimë do ta hartojë Qeveria, ndërsa Agjencia do të merret me monitorim të kësaj strategjie. Sa i përket rolit dhe punës së AKK-së, Havolli ka sqaruar se gjatë vitit 2017 AKK-ja ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në gjithsej 357 raste, prej të cilave 45 janë bartur nga viti paraprak, kurse gjatë vitit 2017 janë pranuar edhe 312 raste. Prej tyre, sipas Havollit, 109 raste



janë përcjellë në prokurori dhe polici për procedim të mëtejshëm, ndërsa 17 raste janë përcjellë në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e

procedurës disiplinore. Ai ka thënë se 92 raste janë mbyllur, ndërsa 139 raste janë në procedurë. Pas një diskutimi të gjerë nga

anëtarë të Komisionit lidhur me punën e kësaj agjencie, raporti vjetor i punës së AKK-së për vitin 2017 mori mbështetjen e komisionit.


Ministri Bytyqi hapi edicionin e 12 të Panairit të Edukimit

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka hapur të enjten edicionin e 12 të Panairit të Edukimit, të cilit këtë vit i është shtuar edhe pjesa e turizmit dhe sportit dhe do të jetë i hapur për vizitorë edhe sot (e premte). Në ceremoninë solemne të këtij panairi që po mbahet në sallën "1 Tetori" në Prishtinë, nën përkujdesjen e Ministrisë së Arsimit, ministri Bytyqi e vlerësoi këtë si një ditë të madhe, për fatin se po vazhdohet tradita e një panairi informues për edukimin në Kosovë. "Ky panair do të shërbejë që të rinjtë tanë t'i kenë informatat me

kohë. Në veçanti, nga ajo që po shihet këtu, kemi një pjesëmarrje të shkollave profesionale, pra ajo që është më se e nevojshme për të rinjtë tanë që të kenë informacione për këto shkolla, që të kenë informacione për orientimin në karrierë, sepse vërtet kemi nevojë që të rinjtë tanë të orientohen drejt mundësive më të mira që i kërkon tregu dhe pas shkollimit të tyre, ta kenë më të lehtë të punësohen", ka thënë Bytyqi. Po ashtu, ai ka theksuar nevojën e informimit të vazhdueshëm dhe vetëdijesimit e përgjithshëm për një edukim sa më të përafërt me vendet e tjera të zhvilluara.



Reforma në administratën publike, e pandalshme

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 19 PRILL - Reforma e administratës publike kërkon rolin dhe efektin e secilit prej nesh në bazë të përgjegjësisë që kemi. Kështu ka thënë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në takim ndërmimor për reformën e administratës publike që është mbajtur të enjten në Prishtinë,

organizuar nga Ministria e Administratës Publike. "Është një proces i madh, kompleks, por më vjen mirë që kemi filluar të definojmë qartë se çfarë përmban dhe si do të ndodhë reforma", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se hartimi i pakos legjislative, që pastaj i jep normë kësaj reforme, i jep siguri çdokujt në funksionim, njëkohësisht krijon edhe sigurinë buxhetore dhe qartëson

funksionimin tonë si administratë shtetërore.

Kryeministri Haradinaj ka thënë pakoja ligjore e ligjeve, që e normojnë ekzistencën tonë si administratë publike, do të jetë një sfidë e madhe, por shprehu përkrahjen e tij të pazezervë për të vazhduar tutje. Ndërsa ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhilar, ka thënë se ky vit do të jetë vit i hapave të mëdhenj në fushën e

administratës publike.

"Ministria e Administratës Publike, ashtu siç është zotuar, në muajin qershor të këtij viti do të përcjellë në Qeveri pakon ligjore të tri ligjeve bazike të administratës publike: Ligjin për Pagat, Ligjin për Shërbimin Civil dhe Ligjin për Organizimin e Administratës Publike", ka thënë Jagxhilar.

Kurse Besnik Tahiri, koordinator nacional për Reforma

Shtetërore, ka thënë se ekziston një vullnet i fortë politik për të përfunduar një reformë e cila përfundimisht do ta normojë hierarkinë institucionale të institucioneve të Kosovës, do t'i ofrojë statusin juridik, do ta nivelizojë pagën mbi parimin për punën e njëjtë dhe pagën e njëjtë dhe do ta kthejë administratën si shtyllën kryesore në rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Evropian.

Kosova arrin progres në fushën e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 PRILL - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur takimi për prezantimin e udhërrëfyesit për gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme për posedimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor brenda vitit 2025.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka thënë se Kosova gjatë dhjetë vjetëve të fundit ka arritur progres në fushën e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta. Sipas tij, që nga viti 2008 është duke u implementuar strategjia dhe plani i veprimit për armët e vogla dhe të lehta. Zeka ka thënë se, bazuar në deklaratën e përbashkët nga takimi i mbajtur në Podgoricë për angazhimin për luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve dhe municionit në Ballkanin Perëndimor, Republika e Kosovës ka bërë prioritet implementimin e këtyre obligimeve. "Është krijuar një grup i punës për harmonizim të mëtejshëm të bazës

ligjore nacionale për armë me BE-në. Kosova është shembulli i parë në rajon për përmbyllje të planit të përbashkët të veprimit në mes të vendeve të BE-së dhe Evropës Juglindore 2015-2019. Kosova ka themeluar pikën kombëtare për armë, e cila është vendosur në Policinë e Kosovës dhe janë ndërmarrë një sërë nismash të tjera", ka thënë zëvendësministri Zeka.

Zëvendësministri Zeka, i cili është edhe koordinatori kombëtar i Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL), vuri në dukje se, përveç rezultateve të përmendura, janë edhe shumë sfida dhe probleme të natyrave të ndryshme. Ai ka thënë se një nga sfidat kryesore në luftën e përbashkët dhe bashkëpunimin ndërkombëtar është edhe mosanëtarësimi i plotë i Kosovës në INTERPOL, EUROPOL, SELEC etj.



Thaçi: Heroizmi i Sali Çekajt do të mbetet inspirim dhe krenari për brezat e rinj

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë pjesë të enjten në akademinë përkujtimore për 19-vjetorin e rënies së heroit Sali Çekaj. Thaçi ka thënë se Sali Çekaj që në vitin 1981 ishte renditur aty ku duhej, me lëvizjen studentore, që fuqishëm i bashkoi gjithë qytetarët e Kosovës rreth kërkesës për ngritjen e statusit të Kosovës në nivel të Republikës. Me të filluar lufta për çlirim të Kosovës, presidenti Thaçi ka thënë se Sali Çekaj, bashkë me kuadro të tjera ofi-

cerësh, me ndërgjegje të lartë dhe profesionalizëm, iu përgjigj momentit historik. "Sali Çekaj iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duke i dhënë impuls të ri, energji dhe profesionalizëm. Prandaj, ai ishte sintezë e intelektualit dhe guerilit, juristit dhe ushtarakut, luftëtarit dhe prijësit në luftë për liri. Tërë këto cilësi ai i dëshmoi në beteja", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se heroizmi i Sali Çekajt do të mbetet inspirim dhe krenari për brezat e rinj. Edhe kryeministri Ramush

Haradinaj ka thënë se heroi i kombit, Sali Çekaj, është një dimension i hershëm, që flet për gjithë parametrat e një atdhetari të shquar, intelektualit, por edhe një njeriu që dinte me çfarë po përballlej. "Këtu flitet për përcaktimin e tij, shohim e gjejmë tek ai një luftëtar që është në parametra shumë të lartë, intelektual e kombëtar, por që është i gatshëm të mbetet në përgjegjësi, edhe kur këto përgjegjësi kërkojnë sfidën më të rëndë, luftën dhe që i ekspozohesh edhe flijimit", ka thënë Haradinaj.

CETEP-i synon shfrytëzimin e potencialit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

**EPOKA
ERE****A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 PRILL - Qeveria e Kosovës ka miratuar të enjten nismën për negociimin e marrëveshjes për bashkëfinancimin dhe zbatimin e përbashkët të Projektit Creating Employment Through Export Promotion (CETEP) "Krijimi i vendeve të reja të punës përmes promovimit të eksportit".

Marrëveshja do të lidhet në mes të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrjes së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik të Gjermanisë (BMZ) dhe do të implementohet nga GIZ-i.

Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrjes, Besim Beqaj, është shprehur i kënaqur me nisjen e negociatave për këtë

marrëveshje pasi, sipas tij, projekti do ta mundësojë shfrytëzimin e potencialit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) për tregjet ndërkombëtare dhe rritjen e punësimit. "Projekti CETEP synon shfrytëzimin e potencialit të NVM-ve kosovare për tregjet ndërkombëtare dhe rritjen e punësimit. Projekti është i përqendruar në tre sektorë të përzgjedhur: bujqësi, teknologji e informacionit dhe komunikim, si dhe prodhimi", ka thënë ministri Beqaj. Ai ka theksuar se synimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrjes është që të përshpejtohet qasja inovative dhe potenciali për eksporte për kompanitë e Kosovës dhe në këtë mënyrë të mbështetet krijimi i qendrueshëm i vendeve të reja të punës.



Partitë politike nuk tregojnë se nga i marrin paratë

PRISHTINË, 19 PRILL - Transparenca rreth burimeve dhe shpenzimeve financiare të partive politike në Kosovë vazhdon të mbetet kërkesë e Komisionit Evropian, e cila është përsëritur edhe në Raportin e Progresit të publikuar ditë më parë. Partitë politike thuhet të kenë vazhduar të mos i bëjnë publike raportet e tyre financiare, ashtu siç edhe është paraparë me Ligjin për financimin e subjekteve politike.

Mbikëqyrja e dobët dhe transparenca e kufizuar e partive ishte kritikuar edhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në Kosovë.



Shmangia e publikimit të burimeve të financimit dhe qarkullimit financiar nga përfaqësuesit të shoqërisë civile në Kosovë, thuhet se ka të bëjë me atë se brenda këtyre financave të panjohura të partive politike

ka diçka të dyshimtë. Arton Demhasaj nga Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet "Çohu", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se raportet financiare të partive politike

vazhdojnë të jenë të mbyllura dhe nuk publikohen në uebfaqen e tyre. Ai ka thënë se niveli i transparencës dhe llogaridhënies karshi financimit të partive politike është në pikën zero. "E gjithë kjo bëhet qëllimisht për shkak se në përgjithësi dhe në bazë të hulumtimeve që ne i kemi zhvilluar, tregon se partitë politike, përveç se shpenzojnë paratë që marrin nga buxheti i Kosovës, shpenzojnë edhe para që i marrin nga bizneset. Kjo ka krijuar një lidhje klienteliste në mes të partive politike dhe bizneseve të caktuara të cilat fillimisht u japin para partive politike, pastaj këto i marrin shumëfish përmes tenderimit publik", ka

deklaruar Demhasaj.

Në bazë të Ligjit për financimin e subjekteve politike, partitë janë të obliguara që të publikojnë për çdo vit raportin vjetor financiar, që duhet ta përmbajë bilancin e gjendjes, pasqyrën e fitimit dhe të humbjes, që tregon të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e partisë. Në vit, partive politike, të cilat janë të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës nga buxheti i Kosovës, u ndahen më shumë se katër milionë euro. Shuma e mjeteve për financimin e aktiviteteve të subjekteve politike bëhet në bazë të përfaqësimit të numrit të ulëseve të fituara në Kuvend për një mandat.

Lluka kërkon mbështetje për agjendën digjitale të Kosovës

SHKUP, 19 PRILL (ER) - Në kuadër të Samitit Digjital për Ballkanin që po mbahet në Shkup, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka takuar komisionaren Evropiane për Ekonomi Digjitale dhe Shoqëri, Mariya Gabriel, me të cilën ka diskutuar për politikat që është duke i ndërmarrë Qeveria e Kosovës për ta fuqizuar transformimin digjital. Me këtë rast, ministri Lluka ka kërkuar përkrahje nga komisionarja Gabriel për fonde shtesë në projekte të reja që kanë të bëjnë me digjitalizimin

industrial, transformimin digjital tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe edukimin e fëmijëve në këtë fushë.

Një temë tepër me rëndësi që u diskutua gjatë këtij takimi ishte përfshirja e Kosovës në marrëveshjen e roamingut me të gjitha vendet e Ballkanit, gjë që do të realizohet. Në kuadër të Samitit Digjital për Ballkanin Perëndimor, Lluka ishte pjesë në panelin e parë me temë Aftësitë Digjitale (Digital Skills), ku është diskutuar për rëndësinë e sektorit në zhvillim ekonomik të ven-

dit dhe ka prezantuar projektin që është para lansimit për shtrirjen e rrjetit brezgjere përmes Bankës Botërore. Gjithashtu, kreu i MZHE-së ka vizituar edhe panairin e kompanive nga sektori i teknologjisë informative, në të cilën po marrin pjesë edhe kompani nga hapësira shoqiptare.

Ministri Lluka është shprehur i kënaqur me praninë e madhe të kompanive dhe ekspertëve nga Kosova, të cilët kanë mundësuar që Kosova të jetë lidere në rajon në fushën e teknologjisë informative.



Limaj nis jetësimin e projektit për çdo familje nga një të punësuar



Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, bashkë me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, kanë mbajtur të enjten takim në Prizren dhe Suharekë me familjet të cilat gjenden në skemë sociale. Limaj në këto takime ka deklaruar se prioriteti kryesor është ofrimi i mundësisë për punësim të një anëtar të familjeve të cilat nuk e kanë askënd të punësuar

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

THERANDË, 19 PRILL - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, gjatë fushatës zgjedhore ishte zotuar se nëse Nisma fiton ose bëhet pjesë e Qeverisë do të bëjë të mundur që çdo familje në Kosovë të ketë së paku një anëtar të punësuar. Ky projekt ka nisur të zbatohet edhe në praktikë.

Zëvendëskryeministri Limaj, bashkë me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, kanë nisur

takimet me familjet përfituese të Skemës së Ndhmës Sociale në të gjitha komunat. Ata të enjten kanë mbajtur takim në Prizren dhe Suharekë me familjet të cilat gjenden në skemë sociale.

Limaj po synon që së paku nga një anëtar i familjeve në skemën sociale t'i përfshijnë në masat aktive të tregut të punës. Numri dy i Qeverisë së Kosovës ka thënë se do t'i ofrohet mundësia për të punësuar secilës familje së paku nga një anëtar. Për të arritur këtë mision, Limaj ka kërkuar bashkëpunimin edhe të

familjeve që janë në asistencë sociale. "Sot jeni të ftuara 176 familje që nuk kanë asnjë të punësuar dhe të cilët janë të aftë për punë. Ideja e këtyre takimeve që do të mbahen anekënd vendit është t'i njoftojmë drejtpërdrejt njerëzit tanë me mundësitë që i ka shteti për t'u ofruar një mundësi djemve e vajzave që të punojnë. Theranda njihet si ndër komunat me njerëzit me punëtorë dhe kemi ardhur t'ju themi juve që merrni ndihmë sociale, a jeni të gatshëm për punë", ka thënë Limaj gjatë një tubimi me banorë të

Therandës të cilët marrin asistencë sociale.

Sipas Limajt, Ministria e Punës ka bërë disa plane dhe po punon në disa drejtime në bashkëpunim me komunat për të hapur vende të reja të punës, në të njëjtën kohë ai ka bërë me dije se janë në kontakt edhe me shtetet mike për të arritur marrëveshje për punësim sezonal. "Djemtë e vajzat e reja që nuk kanë përgatitje profesionale i ftoj të drejtohen drejt qendrave për aftësim profesional. Të shkojnë dhe të marrin nga një zanat. Tregu i punës kërkon njerëz me zanat. Shfrytëzoheni moshën e drejtoheni këtyre qendrave. Unë e di që jetoni një jetë të vështirë dhe e di se askush nga ju nuk do të merrni një ndihmë sociale. E di sa është vështirë për juve ta përmbyllni muajin me ndihmë sociale", ka shtuar Limaj.

Limaj ka thënë se shteti nuk ka kapacitet për ta rritur ndihmën sociale aq sa kanë nevojë familjet që marrin këtë ndihmë. "Unë jam i vetëdijshëm sa është

vështirë të jetohej me asistencë sociale dhe e di se askush nga ju nuk dëshironi të merrni një ndihmë sociale, sepse është shumë vështirë të mbyllet muaji me këtë lloj ndihme", ka theksuar Limaj, duke shtuar se për familjet që nuk kanë mundësi të punojnë, duhet të kujdeset shteti dhe shteti nuk do të heqë dorë nga ky obligim. "Kur kemi thënë se do të ofrohet mundësia që secila familje me asistencë sociale ta ketë nga një anëtar të punësuar, nuk e kemi thënë sa për të thënë. Në Kosovë duhet t'i ofrohet mundësia për të punësuar secilës familje nga një anëtar që është i gatshëm për punë", ka thënë zëvendëskryeministri Limaj. Ndërkaq ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se kanë zgjedhur Therandën e Prizrenin për të nisur këtë projekt i cili ka për qëllim përmirësimin e mirëqenies sociale. "Kemi nisur një projekt i cili ofron mundësi për punësimin tuaj", ka thënë ministri Reçica.

Policia konfiskon pesë revole në tri raste të ndara

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Njësitët policore të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë në tri raste të ndara kanë konfiskuar pesë armë zjarri, një armë të ftoftë, një sprej, si dhe fishekë të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm. Aksioni i parë është realizuar nga njësitët policore të sta-

cionit të Lipjanit, i cili ka rezultuar me arrestimin e një personi të dyshuar, të cilit i janë gjetur dhe konfiskuar dy revole, një thikë, si dhe 66 fishekë të ndryshëm.

Ndërsa dy rastet e tjera të konfiskimit të armëve kanë ndodhur në Prishtinë, ku janë arrestuar tre persona të

dyshuar. Oë nga 1 janari i këtij viti njësitët policore të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë kanë konfiskuar 135 armë, 1 249 municione të llojit dhe kalibrit të ndryshëm dhe janë iniciuar 126 raste mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.



Aliu: Pas traumave nga ish-pushteti, Ferizaj ka hapur kapitullin e stabilitetit

FERIZAJ, 19 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, të enjten ka paraqitur rezultatet e punës së tij për 100 ditë të qeverisjes. Aliu në një konferencë për medie ka thënë se Komuna e Ferizajt është e para nga tri komunat me gjendjen më të rëndë financiare në Republikën e Kosovës. Ai ka bërë me dije se për këto 100 ditë të qeverisjes së tij ka arritur të menaxhojë një krizë të jashtëzakonshme financiare. "I siguroj qytetarët e Ferizajt se të gjitha kapacitetet tona dhe ekspertët më të mirë janë vënë në veprim për ta

parandaluar fiaskon financiare që rrezikon Komuna e Ferizajt nga borxhet dhe përmbaruesit privatë", ka thënë Aliu. Pavarësisht prej kësaj, ai ka thënë se është i vendosur ta çojë përpara vizionin dhe modelin e qeverisjes së mirë. "Ferizaj, pas traumës së pësuar nga ish-pushteti, ka hapur kapitullin e stabilitetit, punës dhe dinamikës së re, përkushtimit maksimal për realizimin e platformës sonë qeverisëse, për ndryshimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve", është shprehur Aliu.

Gjilani fiton 205 mijë euro nga DEMOS-i zviceran

GJILAN, 19 PRILL (ER) - Komuna e Gjilanit si rezultat i punës së mirë në sistemin e menaxhimit të performancës komunale për vitin 2016 është shpërblyer nga organizata zvicerane DEMOS me një grant në vlerë prej 205 mijë eurosh. Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka mirëpritur këtë grant dhe ka falënderuar organizatën zvicerane për vlerësimin e lartë për këtë komunë. "Ky është një vlerësim i jashtëza-

konshëm për Gjilanin. Për herë të parë DEMOS-i shpërblen komunën tonë me një grant prej 205 mijë eurosh. Me këto para dhe me participimin komunës do të fillojmë ndërtimin e pjesës së parë të 'Rrugës së Kumanovës', e cila kap shumën e mbi 350 mijë eurove. Faleminderit edhe koordinitorit të SMPK-së dhe zyrtarëve komunalë për performancën dhe për punën e mirë që kanë bërë", ka thënë Haziri.



Fillon rregullimi i rrugës dhe rrethojës së oborrit në QMF të Llazicës

MALISHEVË, 19 PRILL (ER) - Në kuadër të investimeve për rregullimin e infrastrukturës përcjellëse në fushën e shëndetësisë, të enjten ka filluar realizimi i projektit për hapjen dhe rregullimin e rrugës për Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në fshatin Llazicë të Komunës së Malishevës. Në kuadër të këtij projekti do të rregullohet edhe

rrethoja e oborrit të këtij objekti shëndetësor. Në fillimin e punimeve kanë marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe drejtori i Urbanizmit, Islam Vrenezi. Me këtë rast, Begaj ka thënë se rruga e re në Qendrën e Mjekësisë Familjare do të jetë në shërbim të banorëve të fshatit Llazicë. "Kjo qendër e mjekësisë

ka rëndësi të madhe për fshatin Llazicë dhe fshatrat përreth dhe, pavarësisht prej objektit dhe kushteve të mira që janë, rruga ka qenë problemi kryesor. Prandaj sot po e hapim këtë rrugë, e cila do të jetë tërësisht në shërbim të QMF-së dhe banorëve të kësaj ane, të cilët kanë nevojë për shërbimet shëndetësore", ka thënë Begaj.



FRIKA NGA 'AMBIENTI I MBYTUR ME IDEALIZËM'!



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Këto ditë lexova këtë "margaritar" të një "intelektuali" të ri, i cili "konstatonte": "mes një ambienti të mbytur nga idealizmi - e i cili nuk donte as të shihte e lëre më të mirëkuptonte ambicien individuale...". Shkëputa vetëm këtë pjesë të nënvizuar nga një shkrim i gjatë ku bëhej fjalë për një kohë ndër më të lavdishmet të 100 viteve të fundit, e me të drejtë sulmohet ambienti i sotëm politik.

Me këtë pjesë as që do të merrem, madje nuk do të merrem me asnjë pjesë tjetër të shkrimit, por vetëm me këtë ide të çoroditur të një gjysmë intelektual të prodhuar në periudhën e krizës sonë arsimore. Pa dyshim që ambienti politik viteve të fundit ka përgjegjësi të madhe edhe për këtë nivel të dijeve intelektuale, për çka me vjen shumë keq. Por, edhe kjo është një çështje tjetër dhe e cila kërkon një angazhim serioz të shoqërisë sonë.

Sikur autori të ishte prodhim i periudhës së LKJ-së, të kishte

qenë prodhim i strukturave të ndjekjes apo të mekanizmave dhunues të para viteve 1998/99, nuk do të shkruaja as edhe një fjalë, por është i moshës që, siç thotë populli, i "qesin buzët tamël" dhe i edukuar në vitet e lirisë e të pavarësisë sonë. Madje është krejt normale të merret me emrat e përveçëm të secilit njeri të angazhuar politikisht, por të merret me "ambientin e mbytur me idealizëm", me ambientin që nëse asgjë tjetër nuk ka bërë, e kanë nxitur një luftë çlirimtare, e cila luftë është mbështetur nga bota demokratike dhe si rezultat i saj ka ndodhur një mrekulli që do ta dëshironin shumë popuj të Evropës, se për pjesët tjera të botës as nuk ia vlen të flasim. Përndryshe secili duhet të ndjehet mirë për idealet çlirimtare, që për ndonjërin edhe mund të jenë "ambiente të mbytura nga idealizmi".

Cila është mrekullia?

Së pari, për popullin tonë që për gati një shekull ka jetuar nën robërinë serbe, çlirimi, pavarësia, sovraniteti i shtetit dhe demokracia janë më shumë se mrekulli. Mrekulli tjetër, jo vetëm për shqiptarët e Kosovës, a nuk janë edhe rreth 11.000 km², të gjeografisë kombëtare të cilat i janë kthyer kombit, kuptohet pas shumë sakrificave të më

shumë se tre brezave të shqiptarëve të Kosovës? Për gjeneratat e reja, nëse asgjë tjetër nuk ka ndodhur, ka ndodhur mundësia e krijuar nga "ambienti i mbytur me idealizëm"(!), është krijuar mundësia që me rrugë demokratike të mundësohet ndërimi i pushteteve nga "intelektualët" që kanë lexuar duke belbëzuar ndonjë libër, nëse shquhen për ndonjë lexim të ndonjë libri të mirë. Por, kalemxhiu shkon edhe më tej se kaq dhe deklaron: "e i cili nuk donte as të shihte e lëre më të mirëkuptonte ambicien individuale". Këtu njeriu normal edhe mund të pyet: për çfarë lirie individuale e ka fjalën ky farë "intelektuali"? Në cilën luftë çlirimtare apo lufte në përgjithësi mirëkuptohen liritë e ambicien individuale kur kërcënohet substanca kombëtare, ashtu siç i ishte kërcënuar kombit tonë nga politika e gjenocidit të Beogradit, e cila politikë anti-shqiptare po vazhdon edhe sot? Nuk thuhet kotë: "kur vërgllojnë armët, heshtin muzat". Natyrshëm kur heshtin armët, muzat duhet të jenë në rolin e tyre veprues.

Frika nga idealizmi e jo nga autoritarizmi?!

Nisur nga kjo logjikë tipike sllave, të gjithë brezat e ideal-

izmës shqiptare të pas vitit 1912, na paskan qenë të "mbytur në ambiente idealiste" dhe nuk paskan respektuar "ambicinet individuale", pse shqiptarëve ua paskan lënë amanet dhe trashëgim luftën për liri, për çlirim e bashkim kombëtar. Sipas kësaj logjike inatçore (jo e shëndetshme për moshën e re), sot duhet t'i qesim në bankën e të akuzuarve të gjithë ata shqiptarë që pas Luftës së Dytë Botërore u vranë e u zhdukën në forma të ndryshme mbi 80.000 shqiptarë, t'i dënojmë edhe një herë të gjithë ata idealistë që mbajtën mbi 600 shekuj burg në kazamatet serbe e jugosllave dhe rreth një milion qytetarëve që në forma të ndryshme u detyruan të ikin nga trojet stërgjyshore. Pra të gjithë këta t'i shpallim tradhtarë e tradhtarët t'i shpallim heronj. Se për dëme të tjera materiale që i janë shkaktuar vendit e kombit as të mos flasim. Madje kjo edhe nuk do të ishte hera e parë që ndodh nga një sortë e shqiptarëve! Prandaj jemi kaq mirë sa bota të na marrë lakmi me brezin që frikësohet nga "ambientet idealiste"! Nga ambienti që i krijoi njerëzit me integritet e dinjitet dhe siç po duket edhe integriteti dhe dinjiteti shfaqen në kohë të vështira, kur rreziku për jetën është i madh. Apo,

këto virtyte zvetënohen në kohë shturjeje e anarkie.

Çka është tepër, tepër është! Kësaj i thonë të ardhhtë nga nuk e pret! Se nga politika gjenocide e Beogradit kemi pritur e përjetuar jo pak, sikundër që edhe mund të pritet gjithçka... por këto havadzyet dhe "margaritarët" e "intelektualucëve" si ky që hasa këto ditë nuk i tret mendja! Është interesant, "ambientet mbytëse të idealistëve" (ish të burgosurit politik), ishin pengesë dhe shumë të padëshirueshëm për të gjitha partitë politike të para e të pas luftës çlirimtare, bile është po ky "ambient mbytës i idealistëve" që një parti politike në Kosovë e çoi drejtë ndarjes. Një gjë e kam vërejtur shumë herë në politikë, njerëzit kanë frikë nga autoritetet idealiste dhe jo nga njerëzit autoritarë me prirje despotike!

Frika intelektualëve të rinj nuk duhet të vije nga "ambientet e mbytura me idealizëm", se këto ambiente janë ambiente në të cilat njerëzit janë edukuar për vetëflijim, por, frika reale duhet t'ju vije nga ambientet e mbytura të paditurisë, te mungesës se idealeve, të mafiozitetit e të paligjësive të shumta, të ambienteve nostalgjike të jugos etj. Këto ambientet e fundit po e mbysin perspektivën e njerëzve tanë.

MMPH-ja investon 400 mijë euro në projekte në Gjakovë

GJAKOVË, 19 PRILL - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Albena Reshitaj, ka nënshkruar dy memorandume të enjten në Gjakovë. Njëri memorandum është nënshkruar ndërmjet ministres Reshitaj dhe kryetarit të Gjakovës, Ardian Gjini dhe ka të bëjë me rregullimin e shtratit të lumit Krana me vlerë prej 200 mijë eurosh. "Kam kënaqësinë që sot ndodhem në Gjakovë për t'i konkretizuar projektet kapitale për qytetarët e kësaj komune. Ministria që unë drejtoj do ta mbështesë në vazhdimësi Komunën e Gjakovës, kryetarin Gjini, për realizimin e projekteve në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor", ka deklaruar ministria Reshitaj. Lumenjtë e Kosovës, sipas ministres Reshitaj, janë pasuri që ne duhet t'i mirëmbajmë e të kujdesemi për ta. "MMPH-ja këtë vit do ta bëjë aerofotografinë e tyre për t'i parë saktë

dëmtimet dhe devijimet e shtretërve të lumenjve. Ky projekt do të shoqërohet njëkohësisht me projektet tona për rregullimin e shtretërve të lumenjve në tërë territorin e Kosovës", ka thënë Reshitaj. Ndërkaq kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, ka falënderuar ministren Reshitaj për angazhimin e saj për t'i ndihmuar komunat me projekte të ndryshme në të mirë të mjedisit. Po të enjten në ambientet e Komunës së Gjakovës është nënshkruar edhe memorandum i tjetër ndërmjet ministres Reshitaj dhe kryeshefit të KUR "Gjakova", Ismet Ahmeti. Me këtë memorandum MMPH-ja mbështet projektin për përfundimin e punimeve të ujësjellësit për 28 fshatra të Komunës së Gjakovës në vlerë prej 200 mijë eurosh. "Qasja në ujë të pijshëm është e drejtë primare e qytetarëve. Ky është misioni ynë që secila familje të gëzojë këtë të drejtë", u shpreh ministria Reshitaj.



Rexhep Ismajli, anëtar i Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Amerikës

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Akademik Rexhep Ismajli është zgjedhur anëtar i jashtëm nderi i Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Amerikës (American Academy of Arts and Science). Lajmin e ka bërë me dije kryetari i Akademisë Amerikane, Jonathan F. Fanton. "Ky nderim shënjon konsideratën e thellë që kanë drejtuesit e fushës suaj dhe anëtarët tanë",

ka thënë Fanton. Akademia e Arteve dhe të Shkencave të Amerikës është themeluar më 1780 nga disa nga themeluesit e ShBA-së, Benjamin Franklin, John Adams, Thomas Jefferson e George Washington. Në mesin e anëtarëve të saj janë mbi 200 fitues të Çmimit Nobel dhe të Çmimit Pulitzer. Ndër emrat më të njohur që kanë qenë anëtarë të

kësaj Akademie janë edhe Charles Darwin, Albert Einstein, Alexander Graham Bell, Winston Churchill, Akira Kurosawa, John Updike e Nelson Mandela. Në mesin e anëtarëve që janë pranuar sivjet është edhe ish-presidenti amerikan Barack Obama. Akademik Ismajli do të marrë pjesë në ceremoninë e pranimit në Cambridge, Massachusetts, në tetor të këtij

viti. Rexhep Ismajli (1947) është gjuhëtar, student i Andre Martinet në Paris, profesor i Universitetit të Prishtinës, anëtar i ASHAK-ut që nga viti 1993. Në janar të këtij viti ai është zgjedhur edhe anëtar i përhershëm nderi i Shoqatës së Linguistëve të Amerikës Linguistic Society of America (LSA) që është institucioni më i rëndësishëm



shkencor për çështje të gjuhësisë, duke qenë autoriteti i vetëm nga Evropa Juglindore i zgjedhur në këtë institucion.

Hapet Panairi i Shkencës dhe Kulturës 2018

MITROVICË, 19 PRILL (ER) - Në ambientet e Qendrës së Kulturës "Rexhep Mitrovica" në Mitrovicë është hapur Panairi i Shkencës dhe Kulturës 2018, që tashmë është bërë tradicional dhe që organizohet nga nxënësit e Gjinnazit "Frang Bardhi". Në panairin e sivjetmë marrin pjesë edhe nxënësit e shkollave të tjera të mesme të Mitrovicës. Anëtarët e Këshillit Organizativ, Rexhep Avdiu dhe Endrit Haliti, thanë se në panair do të tregohen vlerat e nxënësve që kanë arritur në lëndët shkollore si Kimi, Fizikë, Biologji, Astronomi dhe sektori multimedial e teknologji. Po ashtu, do të tregohen edhe vlera nga kultura e muzika, si dhe do të ketë aktivitete nga fusha e bamirësisë.

Panairin e vizituan edhe kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim

Bahtiri dhe drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci.

Kryetari Bahtiri e cilësoi këtë panair si ngjarje me rëndësi për qytetin për dëshmimin e punës së madhe që bëhet në këtë shkollë si burim i dritës dhe edukimit. "Puna juaj është tregues i mirë i aktiviteteve dhe angazhimit që bëhet në këtë shkollë, andaj ju do ta keni mbështetjen e vazhdueshme edhe në të ardhmen për organizime të kësaj lloji, sepse në ju mbetet e ardhmja e vendit", ka deklaruar Bahtiri.

Ndërkaq drejtori i gjinnazit, Ismet Ferizi, ka shprehur kënaqësinë që nxënësit e kësaj shkolle, ashtu sikur edhe në të kaluarën, me këtë organizim pasqyrojnë punën e madhe që bëhet në këtë tempull të dijes në drejtim të edukimit dhe arsimimit të gjeneratave të reja.



Në këtë panair, i cili do të zgjasë tri ditë, po marrin pjesë rreth 200 nxënës, të organizuar në 28 sek-

torë. Panairi qysh në ditën e parë ka zgjuar interesim të madh tek të rinjtë dhe qytetarët e tjerë të

Mitrovicës. Organizatorët presin që panairin ta vizitojnë rreth 6 000 qytetarë.

Nënshkruhet marrëveshja për fuqizimin e rinisë përmes edukimit joformal

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Në kabinetin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, është nënshkruar të enjten një marrëveshje bashkëpunimi me organizatën joqeveritare "George Williams Association in Kosovo".

Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i angazhimeve të ndërsjella në mes të MKRS-së dhe OJQ George Williams Association in Kosovo për fuqizimin e rinisë në Kosovë dhe zbatimin e projektit "Qendra rekreative për fëmijë dhe të rinj", me lokacion në fshatin



Pjetërshan në Komunën e Gjakovës, si dhe promovimin e edukimit joformal si element

shumë i rëndësishëm për zhvillimin e të rinjve në vendin tonë. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe

Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se MKRS-ja do ta vazhdojë mbështetjen e të rinjve me qëllim të krijimit dhe përmirësimit të kushteve për zhvillimin e aktiviteteve rinore. Po ashtu, ai ka theksuar se përmes nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve po synohet të promovohet edhe më tutje Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë. "Zbatimi i këtij projekti ofron një platformë dhe infrastrukturë fizike me kushte shumë të mira për zhvillimin e aktiviteteve për fëmijët e të gjitha shkollave dhe të rinjtë e të rejtat nga komunitetet

pakicë, personat me aftësi të kufizuara, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet shtetërore", është shprehur ministri Gashi.

Ndërsa drejtoresha e organizatës "William Youth Association in Kosovo", Dorina Davies, u shpreh e lumtur për nënshkrimin e kësaj marrëveshje, duke thënë se do të vazhdojnë të punojnë intensivisht që nëpërmjet aktiviteteve dhe infrastrukturës vizita studimore të ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve kosovare për udhëheqjen e qendrave të tilla.


"Viti i Majmunit", premierë në Festivalin e Moskës dhe Shkupit

SHKUP, 19 PRILL (ER) - "Viti i Majmunit" (Year of the Monkey), që ka në kastë edhe aktorët shqiptarë si Çun Lajçi e Refet Abazi, ka hapur të enjten festivalin e Shkupit. Ndërsa më 23 prill filmi do të jepet premierë ndërkombëtare në edicionin e 40 të Moscow International Film Festival, njëherësh festival i kategorisë "A".

Filmi flet për shimpanzën Coco që arratiset nga kopshti zoologjik në Shkup, nga robëria në liri, në të njëjtën kohë roja e kopshtit zoologjik "Coben" largohet nga puna për arsye të krizës ekonomike si dhe nga reputacioni i tij si rreng-anarkist. Mirëpo ai merr një premtime nga drejtori i tij se, nëse mund të gjejë të arratisur dhe ta sjellë në

kopsht, atëherë ai mund t'i kthehet punës së mëparshme.

"Viti i Majmunit", me skenar dhe regji nga Vladimir Blazevski, është bashkëprodhim mes Maqedonisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Kosovës, i mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK) dhe me bashkëproducent Agon Ukën.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

MILLWALL - FULHAM

1

COVENTRY - STEVENAGE

1

MEPPEN - LOTTE

1

'Fushë-Kosova' synon të lë gjurmë në gjimnastikë

Klubi i Gjimnastikës "Fushë-Kosova" ka pasur një zhvillim të mirë, duke bërë që brenda tre vjetësh ky sport të bëhet edhe më i dashur për fëmijët e qytetit të Fushë-Kosovës. Rezultatet nuk po i mungojnë, kurse në të ardhmen ato pritet të jenë edhe më të mëdha

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 PRILL - Trajnerja e Klubit të Gjimnastikës "Fushë-Kosova", Sherife Aliçkaj-Qerimi, në një intervistë për "Epokën e re" është shprehur e kënaqur me rritjen e këtij klubi, i cili është themeluar në nëntor të vitit 2015. Ajo ka treguar se rezultatet nuk kanë munguar deri tash, kurse në garën e radhës që mbahet të shtunën, nikoqir i së cilës është Klubi i "Fushë-Kosovës", synohet të arrihen edhe rezultate të reja. "Në bashkëpunim me Departamentin e Kulturës, Rinisë

"Epoka e re": Kur është themeluar Klubi i Gjimnastikës "Fushë-Kosova"?

Aliçkaj-Qerimi: Klubi i "Fushë-Kosova" është themeluar në nëntor të vitit 2015 dhe deri tash ka pasur zhvillim relativisht të mirë. Aktualisht numërojmë mbi 20 nxënës, kurse ky numër pritet të rritet gjatë javëve në vazhdim.

"Epoka e re": Nga kush është themeluar ky klub dhe si ka lindur ideja për themelimin e një klubi të tillë, pasi gjimnastika në atëkohë nuk ishte edhe aq sport i popullarizuar në Kosovë?

Aliçkaj-Qerimi: Jam profesore dhe e



themelimin e këtij klubi ka qenë shumë i rëndësishëm për faktin se fëmijët tanë kanë mundësinë ta zhvillojnë aktivitetin e tyre edhe në sportin e gjimnastikës.

"Epoka e re": Sa është vështirë të udhëhiqet një klub, kur dihet se mungojnë mjetet financiare?

Aliçkaj-Qerimi: Ka vështirësi por, meqë vullneti nuk mungon, e kemi me lehtë të udhëheqim këtë klub duke e ditur që, në mos më shumë, ndikon konkretisht në zhvillimin e fëmijëve. Prandaj për ne kjo gjë është e rëndësishme dhe na jep kurajë të mos ndalemi për asnjë moment.

"Epoka e re": Sa i plotësojnë kushtet me vegla të gjimnastikës sallat ku i kryeni përgatitjet?

Aliçkaj-Qerimi: Ka mungesa të shumta të pajisjeve të nevojshme për sportin e gjimnastikës, por me ato që i kemi përpiqemi t'ia dalim disi, pasi sporti i gjimnastikës kërkon sallë me infrastrukturë të posaçme. Me veglat dhe mundësitë që i kemi përpiqemi t'i shfrytëzojmë në maksimum që gjimnastët tanë të jenë sa më të përgatitur.



dhe Sportit të Komunës së Fushë-Kosovës kemi bërë përgatitjet e duhura për organizimin e garave në të cilat do të jemi nikoqirë dhe presim që gjimnastët e klubit tonë të arrijnë të korrin rezultate, pasi jemi përgatitur maksimalisht për këto gara", ka thënë Aliçkaj-Qerimi

Edukatës Fizike dhe e kam parë që fëmijët janë shumë të interesuar për sportin e gjimnastikës dhe kështu lindi ideja për themelimin e një klubi që më pas vendosem ta quajmë "Fushë-Kosova". Bashkëthemelues janë edhe dy kolegët e mi, Besnik Latifi dhe Arjeta Jashari. Mund të them se tash, pas tre vjetësh, vendimi për

shumta dhe shpresojmë të pajisejme me elemente gjimnastikore.

"Epoka e re": Cili është bashkëpunimi me Federatën e Gjimnastikës dhe a keni përkrahje të saj?

Aliçkaj-Qerimi: Për momentin Federata e Gjimnastikës na mbështet vetëm moralisht dhe në organizimin e garave që mbahen herë pas here. Shpresojmë që në të ardhmen të kemi më shumë përkrahje nga federata dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pasi për t'i përgatitur gjimnastët, duhen kushte më të mira në infrastrukturë dhe financiare.

"Epoka e re": Vitet e fundit kanë filluar të shpeshohen garat në gjimnastikë. Sa jeni të kënaqur me mbarëvajtjen e këtyre garave dhe rezultatet e garuesve tuaj? Aliçkaj-Qerimi: Duke marrë parasysh se klubi ynë është i ri dhe vështirësitë në infrastrukturë që i kemi, mund të them se jemi shumë të kënaqur me arritjet e gjimnastëve tanë në garat e orga-

"Epoka e re": Po cili është interesimi i të rinjve dhe të rejave të grupmoshave të ndryshme për t'u marrë me këtë sport?

Aliçkaj-Qerimi: Interesimi është i kënaqshëm. Ka shumë të interesuar për këtë sport, por mundësitë janë shumë të kufizuara sepse hapësirat që i



kemi për këtë sport nuk po na lejojnë ta rrisim numrin e gjimnastëve. Për momentin kemi mbi 20 gjimnastë të moshave të reja, por në ndërkohë do ta rrisim numrin sepse kërkesat janë të

nizuara, në të cilat kemi fituar disa medalje. Në të ardhmen presim të marrim medalje dhe t'i rrisim sukseset në garat ku marrim pjesë.

"Epoka e re": Më 21 prill jeni nikoqir i garave të organizuara nga klubi juaj dhe FGJK-ja. Sa jeni përgatitur për këto gara dhe a pritni të merrni medalje?

Aliçkaj-Qerimi: Në bashkëpunim me Departamentin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Fushë-Kosovës kemi bërë përgatitjet e duhura për organizimin e garave në të cilat do të jemi nikoqirë dhe presim që gjimnastët e klubit tonë të arrijnë të korrin rezultate, pasi jemi përgatitur maksimalisht për këto gara.



Të dielën zhvillohet "El Clasico"

BARCELONË, 19 PRILL - Barcelona do ta presë Real Madridin në "El Clasico" numër katër të sezonit, në "Camp Nou", të dielën më 6 maj, në orën 20:45. Të dyja ekipet do t'i kenë edhe tre ndeshje të tjera pas kësaj sfide

dhe ka të ngjarë që Barça ta sigurojë titullin pikërisht kundër rivalëve historikë. Kohët e fundit trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, ka hedhur poshtë mundësinë që lojtarët e Real t'i duartrokasojnë në korridor futboll-

listët e Barcelonës, ashtu si ndodh me kampionët në Premierë Ligë. Barcelona fitoi 3-0 në 'Bernabeu' në fazën e parë, ndërsa Madridi e mposhti Barçën në Superkupën e Spanjës me rezultatin e përgjithshëm 5-1.



Këtë fundjavë përfundon sezoni i rregullt në basketboll

PRISHTINË, 19 PRILL - Me ndeshjet e xhiros së XXVIII në IP Superligën e Kosovës në basketboll do të përmbyllet edicioni i rregullt, ku tashmë është gjithçka e qartë sa i përket pjesës së epërme të tabelës, derisa asaj të poshtme ende mbesin disa gjëra për t'u sqaruar në këtë fundjavë. Sot (e premte) janë në program dy ndeshje, ajo në mes të Trepçës dhe Bashkimit (19:00), si dhe dueli ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Rahovecit (19:30). Ndërkaq të shtunën Golden Eagle Ylli e pret Borean me fillim nga ora 19:00, si dhe të dielën Kerasan Prishtina është nikoqire e Pejës, takim ky që do të luhet duke filluar nga ora 19:00. Skuadrat që tashmë e kanë siguruar "play-off"-in janë Sigal Prishtina, Bashkimi, Rahoveci dhe Golden Eagle Ylli, ku në gjysmëfinale do të përballen Sigal Prishtina-Golden Eagle Ylli dhe Bashkimi-Rahoveci. Ndërkohë në pjesën e poshtme të tabelës ende



është situata e paqartë, ku tashmë dihet vetëm se Trepça është e pesta dhe për Kerasan Prishtinën,

Borean e Pejën vazhdon lufta për mbijetesë në elitë, apo edhe për t'i ikur "play-out"-it.

LeBroni shkëlqen ndaj Indianës, fitojnë edhe Houstoni e Jazzi

OHIO, 19 PRILL - Cleveland barazon 1-1 serinë e ndeshjeve çerek-finaleve të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes. Skuadra e Cavaliersit fitoi me vështirësi 100-97 ndaj Indianës, në një ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund, të dominuar nga basketbollistët vendas. Një ndeshje fantastike e LeBron Jamesit, autor i 46 pikëve dhe 12 rebaundeve, më i miri në fushë për vendësit, ndërsa për Indianën nuk mjaftuan 22 pikët e Oladipo për të fituar. Por Indiana largohet nga këto dy ndeshje në fushën e Clevelandit me një fitore. Barazim 1-1 edhe në përballjet në mes të Utah Jazzit dhe Oklahomës. Ekipi i Jazzit fitoi 102-95 ndaj Thunderit, sfidë ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra, sfidë e hapur deri në fund. Mitchell me 28 pikë, Rubio me 22 dhe Favorsi me 20 bënë diferencën në parket për miqtë, ndërsa për Oklahomën u dallua Westbrook me 19 pikë e 13 asistime, por që mbetën për statistikë. Houstoni hedh një hap tjetër drejt kualifikimit në gjysmëfinale të "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit, pas



fitores 102-82 ndaj Minnesotës, duke udhëhequr 2-0 me ndeshje. Sukses i lehtë për ekipin e Rocketsit,

që ishte superior në fushë, ndeshje ku Chris Pauli realizoi 27 pikë e Greeni 21 pikë e 12 rebaunde.

KONFERENCA E LINDJES

1-8, Toronto - Washington	(2-0 me ndeshje)
2-7, Boston - Milwaukee	(2-0 me ndeshje)
3-6, Philadelphia - Miami	(barazim 1-1 me ndeshje)
4-5, Cleveland - Indiana	100-97 (barazim 1-1 me ndeshje)

KONFERENCA E PERËNDIMIT

1-8, Houston - Minnesota	102-82 (2-0 me ndeshje)
2-7, Golden State - San Antonio	(2-0 me ndeshje)
3-6, Portland - New Orleans	(barazim 1-1 me ndeshje)
4-5, Oklahoma - Utah Jazz	95-102 (barazim 1-1 me ndeshje)

SHKURT

"Birra Peja", sponsore e Besës

Kryetari i Klubit të Futsallit Besa nga Peja, Adnan Hyseni, ka arritur marrëveshje me kompaninë e fuqishme "Birra Peja" për sponsorizim deri në fund të kampionatit. "Ne si klub i jemi shumë mirënjohës kompanisë 'Birra Peja' për vendimin pozitiv që ka marrë duke qenë pjesë e jona në aspektin e sponsorizimit dhe duke ndihmuar klubin në aspektin financiar. Ky bashkëpunim na jep mundësi të jemi edhe më të fuqishëm kur dihen shpenzimet e shumta dhe çastet e vështira që klubi Besa ka në këtë kampionat", thuhet në njoftimin e Besës.

E ardhmja e Mustafit e Xhakës tek Arsenalit, e pasigurt

Mbrojtësi Shkodran Mustafi dhe mesfushori Granit Xhaka nuk e kanë të sigurt nëse do të jenë pjesë e Arsenalit edhe në edicionin e ardhshëm. Të dy shqiptarët, siç raportojnë mediumet në Angli të mërkurën, nuk kanë arsyetuar pritshmëritë dhe gjasat janë të mëdha që gjatë verës të përfshihen në listën e lojtarëve që do të jenë në shitje. Mustafi i kushtoi Arsenalit 41 milionë euro, kurse Xhaka 45 milionë. Por pas këtij edicioni të vlerësuar jo të mirë për dy futbollistët shqiptarë, vlera e tyre në treg ka rënë. "Arsenalit këtë verë do ta rishikojë ekipin dhe vetëm dy vjet pas transferimit të tyre, Mustafi dhe Xhaka nuk janë në plane për të ardhmen", shkruan "standard.co.uk". Si Mustafi ashtu edhe Xhaka me Arsenalin kanë kontratë deri në vitin 2021. Mustafi ka shënuar tre gola dhe ka asistuar një herë në 24 paraqitje në Premierë Ligë këtë sezon, kurse Xhaka në 33 paraqitje ka shënuar një gol dhe ka asistuar pesë herë.

Zidane: Ndaj Bayernit nuk mjafton vetëm Ronaldo

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, është i pakënaqur nga rezultati i ndeshjes kundër Bilbaos (1-1). Ai ka folur edhe për ndeshjen ndaj Bayern Munchenit, duke thënë se ndaj gjermanëve nuk mjafton vetëm Cristiano Ronaldo. "Ronaldo është super dhe po e shijon këtë moment, por duhet të jemi të gjithë mirë për Bayernin. Vetëm ai nuk mjafton. Do të kemi pak pushim këto ditë, pastaj do ta nisim punën për Bayernin", ka thënë Zidane.

Insigne: Duhet ta mposhtim Juven për 'Scudetto'

Lorenzo Insigne ka motivuar ekipin e Napolit para duelit të drejtpërdrejtë me Juventusin në Serinë A. Ai ka thënë se për ta fituar "Scudetton", duhet të dalin fitues nga "Allianz Stadium". "I jemi afruar Juventusit në tabelë, por duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë. Ndeshja më e vështirë do të jetë të dielën, të cilën duhet ta fitojmë. Është mënyra e vetme për të shpresuar në 'Scudetto'", ka thënë Insigne.

Kroosin në vend të Pogbas në United

Manchester United është vënë seriozisht në kërkim të një mesfushori me peshë për afatin kalimtar veror. Largimi i Paul Pogbas duket në horizont dhe marrëdhëniet me trajnerin Jose Mourinho duken gjithmonë më të këqija. Në krye të listës është Toni Kroos i Real Madridit, i cili pëlqehet tej mase nga Mourinho. Nëse dështon transferimi i Kroosit, atëherë në listë janë Jorginho i Napolit, Fred i Shakhtar Donetsk, Julian Weigl i Borussia Dortmund dhe Carlos Soler i Valencias.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

KONKURS

Në bazë të Nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike shpall konkurs për këtë vend pune:

Titulli i vendit të punës:

Sekretar i Zyrës së Presidentit të Kosovës (1).

Paga mujore: 1.171.17 € bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Administrimi dhe menaxhimi i gjithëmbarshtëm i Zyrës së Presidentit dhe sigurimin e zbatimit të funksioneve të besuara të Zyrës; sigurimin e informatave të sakta dhe për këshilla të paanshme e profesionale për Presidentin; organizimin e Zyrës dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për çfarëdo çështje lidhur me funksionin e saj; menaxhimin e efektiv dhe efikas të resurseve që i sigurohen Zyrës; zbatimin e politikës jo diskriminuese ndaj personelit të Zyrës, duke përfshirë përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet, dhe sigurimin që struktura e personelit të pasqyrojë karakterin shumë etnik të Kosovës dhe siguron që punësimi i personelit të Zyrës të bazohet në kualifikime profesionale, kompetenca dhe merita dhe kjo të bëhet përmes konkurrencës së drejtë dhe të hapur; nxjerrjen e akteve të brendshme nënligjore në mbështetje të kryerjes së funksioneve të Presidentit të Republikës të përcaktuara me Kushtetutet dhe me ligj.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar; janë në posedim të të drejtave civile dhe politike; kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimit e funksioneve administrative, që sipas ligjit kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrencës:

- Konkurrimi për pozitën e Sekretar është i hapur dhe kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë nëpunësit civilë në pozita të larta drejtuese, pozita drejtuese ose në pozita të barsvlershme në institucionet e administratës publike apo në kompanitë publike ose private.

Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë universitare (minimum 4 vjeçare pas shkollës së mesme) apo të avancuar, e përfunduar në fushat e drejtësisë, ekonomisë dhe administratës publike.

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Duhet të kenë shkathhtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit; aftësi të larta organizative dhe drejtuese; aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit; aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve; njohuri bazike në programet e kompjuterit; standarde të integritetit; ndershmërisë dhe drejtësisë.
- Së paku 8 vjet përvojë pune profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues pas diplomimit në universitet.
- Njohja e gjuhëve të huaja ka përparësi në rast të vlerësimit të barabartë të kandidatëve.
- Njohjen aplikantët se pjesë e vlerësimit të përgjdhjes do të jenë kriteret e hollësishme të paraqitura në përshkrimin e vendit të punës.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

- Përzgjedhja e Sekretarit bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit:

- Mandati për pozitën e Sekretarit është 3 vjet.

Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit.

Paraqitja e kërkesave:

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Zyra e Personelit, dhoma nr. 320, kati III, ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.rks-gov.net>
- Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës; dëshminë për përvojën e punës; dëshminë se nuk është në hetim apo i dënuar për vepër penale (e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së këtij konkursi) dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.
- Aplikuesit duhet të paraqesin: 1) një CV; dhe 2) një letër motivim me shpjegime të qarta dhe shembuj nga përvoja profesionale që tregojnë se si përvoja dhe aftësitë e tyre përputhen me kërkesat e vendit të punës.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë."

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
- Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin për verifikim dokumentet origjinale.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni znj. Sala Shala në tel: 038-20030620, prej orës 8:00 - 16:00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

KONKURS

Na osnovu člana 15 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i člana 8 Uredbe br. 06/2010 o Proceduri imenovanja u Visokim Upravnim Pozicijama u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Javne Uprave objavljuje konkurs za sledeće radno mesto:

Naziv radnog mesta:

- Sekretar Kancelarije Predsednika Kosova (1).

Mesečna Plata: 1.171.17 € bruto.

Zadaci i odgovornosti:

- Za celokupno upravljanje i menadžiranje Kancelarijom i da obezbedi sprovođenje poverenih zadataka Kancelarije; za obezbedenje tačnih informacija i za nepristrasne i stručne savete za predsednika; za pronalaženje osoblja i organizovanje Kancelarije i donošenje podzakonskih akata o bilo kom pitanju u vezi sa njenim funkcionisanjem; za efektivno i ofikasno upravljanje resursima koji se obezbeduju kancelariji; za sprovođenje nediskriminatorske politike prema osoblju Kancelarije, uključujući ravnopravno predstavljanje polova u svim oblastima i nivoima i da obezbedi da struktura osoblja odražava multietnički karakter Kosova; da obezbedi da zapošljavanje osoblja Kancelarije bude prema stručnim kvalifikacijama, kompetencijama i zaslugama i da se to obavi putem pravednog i otvorenog konkurisanja; za donošenje internih podzakonskih akata za podržavanje obavljanja funkcija predsednika Republike utrdjenih Ustavom i zakonom.

Uslovi učestvovanja regrutiranja su:

- U Civilnoj službi, imaju pravo da se zapošljavaju svi državljani Republike Kosova koji su odraslog doba i koji imaju punu sposobnost delovanja; koji poseduju civilna i politička prava; koji poseduju neohodno obrazovanje i stručnu spremu za obavljanje ekzekutivnih zadataka, upravljanja ili sprovođenja administrativnih funkcija i da imaju fizičku sposobnost, koje su neophodne prema zakonu za dotičnu poziciju.

Procedure konkursa:

